VENDIM
Nr.584, datë 5.9.2007

PËR KALIMIN NË ADMINISTRIM TË KESH SHA-SË, TË NJË SIPËRFAQEJE, PËR NDËRTIMIN E NJË TEC-I, NË KOMUNËN QENDËR, NË VERI TË PORTIT TË RI TË VLORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", të neneve 13 e 15, shkronja "c" të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", të ndryshuar dhe të pikës 1 të nenit 17 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në administrim të KESH sh.a.-së, për ndërtimin e një TEC-i, në komunën Qendër, në veri të portit të ri të Vlorës, të sipërfaqeve si më poshtë vijon, në pronësi të shtetit dhe në administrim të:

- Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (fondi pyjor), konkretisht: zona kadastrale 8604:

a) Pasuria nr.47/58, sipërfaqe 8 500 m^2, pyll;
b) Pasuria nr.47/61, sipërfaqe 7 000 m^2, pyll;
c) Pasuria nr.47/64, sipërfaqe 17 000 m^2, pyll;
ç) Pasuria nr.47/65, sipërfaqe 22 000 m^2, pyll;
d) Pasuria nr.47/67, sipërfaqe 17 075 m^2, pyll;
dh) Pasuria nr.47/71, sipërfaqe 25 000 m^2, pyll;

Në total sipërfaqen 96 575 m^2, pyll.

- Qarkut të Vlorës, konkretisht: zona kadastrale 8604:

a) Pasuria nr.47/63, sipërfaqe 2 800 m^2, ranishte;
b) Pasuria nr.47/66, sipërfaqe 2 800 m^2, rrugë (ranishte);
c) Pasuria nr.47/70, sipërfaqe 34 000 m^2, ranishte;

Në total sipërfaqen 39 600 m^2, ranishte.

2. Ngarkohen KESH sh.a.-ja për kryerjen e procedurave të nevojshme ligjore për regjistrimin, si asete të paluajtshme të saj, të pasurive të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Drejtori i Përgjithshëm i KESH sh.a.-së dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha